Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 108/17
Data/Datum 23.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 108/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje prej **Goran Milenković - Kryetar, Tefik Sylejmani – Referues** dhe **Nuhi Paçarizi- Anëtar,** duke vendosur sipas kërkesës së OE **N.T.P. "FLAMURI"** me seli në Suharekë, për tërheqje të ankesës me nr. të protokollit 108/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetve zyrtare** me nr. të prokurimit: 624/17/108/221, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Komuna e Suharekës, në seancën e dt. 17 maj 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, kërkesa e operatorit ekonomik **N.T.P. "FLAMURI"** me seli në Suharekë, për tërheqje e ankesës me nr. të protokollit 108/17, të dt. 08 maj 2017, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetve zyrtare** me nr. të prokurimit: 624/17/108/221.

II. **AUTORIZOHET,** autoriteti kontraktues Komuna e Suharekës të vazhdoj me procedurat e mëtutjeshme për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetve zyrtare** me nr. të prokurimit: 624/17/108/221.

III. Operatorit ekonomik ankues **N.T.P. "FLAMURI"** me seli në Suharekë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

IV. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik **N.T.P. "FLAMURI"** me seli në Suharekë, si palë e pa kënaqur, më dt. 11 prill 2017, ka parashtruar ankesën me nr. të prot. 108/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurmit me titull: **"Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetve zyrtare** me nr. të prokurimit: 624/17/108/221, të iniciuar nga autoriteti kontraktues- Komuna e Suharekës. Operatori ekonomik ankues pretendon se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 1, nenit 6, nenit 26 , nenit 58, nenit 59 dhe nenit 60 të LPP-së, si dhe nenit 18 pragrafi 18.4, nenit 28 paragrafi 28.2 te Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 21 prill 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik, me dt. 02 maj 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport sqaron se nuk qëndroj pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoritetit kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, per faktin se operatori ekonomik ankues nuk i ka plotësuar çmimet për njësi në të gjitha pozicionet e përshkruara. Me këtë rast autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore, sepse nuk lejohet mos vendosja e vlerës numerike në pozicionet e çmimeve, madje as zeroja nuk do të pranohej si vlerë edhe po të ishte vendosur.

Po ashtu, eksperti shqyrtues/teknik sqaron se ky veprim është në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, gjegjësisht kërkesës së formularit "*Përshkrimi i çmimeve*". Për më tepër, Udhëzimi i KRPP, rreth këtyre situatave rikonfirmon të drejtën e autoritetit kontraktues për eliminim të ofertës, ku tekstualisht qartësohet se: "*Nëse Operatori Ekonomik ofron çmimin "0.00" në një nga pozicionet, tenderi duhet të refuzohet ngase në "Përshkrimin e çmimeve" kërkohet të vendoset çmimi në vlerë të caktuar për secilin artikull/pozicion të kërkuar në specifikimin teknik.*"

Eksperti shqyrtues/teknik në raportin e ekspertizës sqaron se autriteti kontraktues gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë disa lëshime procedural, mirëpo këto lëshime procedural nuk kanë pas ndikim substancial në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues të tenderit.

Eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues ta refuzoj si të pa bazuar, ndërsa ta aprovoj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për dhënie të kontratës, dhe të njëjtit t'i lejohet të vazhdojë me procedurat e mëtejme të prokurimit konform dispozitave të LPP-së.

Operatori ekonomik **N.T.P. "FLAMURI"** me seli në Suharekë, më dt. 08 maj 2017, ka parashtruar kërkesë në OSHP, për tërheqjen e ankesës ku thuhet: *në raportin nr. 108/17, të dt. 02 maj 2017, të nxjerrë nga eksperti shqyrtues/teknik, është konstatuar se në disa elemente ka pasur anashkalime të procedurave të prokurimit si dhe ka vlerësuar se këto devijime nuk kanë pasur ndikim substancial në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues të tenderit. Pra duke parë se disa nga pretendimet tona për shkelejt e Ligjit nga autoriteti kontraktues i ka vërtetuar, por i ka konsideruar si shkelje të cilat nuk kanë pasur ndikim në procedurë e prokurimit në fjalë, ne nuk kemi inters juridik lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, prandaj vendosëm që ta tërheqim ankesën tonë. Në bazë të nenit 30 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr, 01/2017, kërkojm që të na kthehet sigurimi në vlerë e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.*

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së operatorit ekonomik ankues, aprovon kërkesën për tërheqjen e ankesës të **N.T.P. "FLAMURI"** me seli në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja dhe servisimi i automjetve zyrtare** me nr. të prokurimit: 624/17/108/221, të iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Suharekës.

Duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores së Punës së OSHP-së, paneli shqyrtues konstaton se pala mund të tërheq ankesën në çdo kohë para dëgjimit apo diskutimit të panelit shqyrtues. Në rast të tilla depozita apo sigurimi duhet t'i kthehet ankuesit. Paneli shqyrtues në pajtim me nenin 30 të Rregullores së Punës së OSHP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1. 1x1 AK – Komuna e Suharekës
2. 1x1 OE N.T.P. "FLAMURI" me seli në Suharekë
3. 1x1 Arhivës së OSHP-së